

VENDIM
Nr.54, datë 21.11.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Halil Kopani,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 30.10.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.55 Akti që i përket:

KËRKUES: RIDVAN RESULI,

SUBJEKT I INTERESUAR: DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTITARE, e përfaqësuar nga Av. Ilir Panda, me autorizim.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.186, datë 13.2.1996 të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi kërkesin, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi, trashëgimtar i të ndjerit Ahmet Resuli, duke pasur dokumenta shkresore për pronësinë e një trualli të ndodhur në Tiranë dhe të shtetëzuar në vitin 1948, ka pretenduar se në kohën e shtetëzimit në këtë truall ka qenë ngritur një ndërtesë dykatëshe e pambaruar për shkak të luftës. Aktualisht, në këtë truall është një ndërtesë, pronë e shtetit (administruar nga Drejtëria e Shërbimeve Qeveritare). Mbi kërkesën e trashëgimtarëve, gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin nr.3140, datë 26.5.1995, i ka njohur ata si bashkëpronarë me shtetin mbi këtë ndërtesë.

Në datën 17.1.1996, kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në bazë të dispozitave procedurale civile në fuqi, ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të mësipërm me pretendimin se ai është arsyetuar në kundërshtim me provat e administruara dhe në mënyrë jo logjike.

Mbi këtë bazë, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.186, datë 13.2.1996 ka vendosur : "Prishjen e vendimit nr.3140, datë 26.5.1995 të gjykatës së rrethit Tiranë dhe rrëzimin e padisë...".

Në arsyetimin e këtij vendimi, kolegji civil vlerëson provat e administruara nga gjykata e faktit, duke arritur në përfundim se : "Vendimi nuk mbështetet në provat e administruara..."; se "... nga të gjitha provat që ndodhen në dosje është vërtetuar në mënyrë të plotë se ndërtesa... është ndërtuar nga themelet nga shteti", etj.

Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë ç'ka presupozon shqyrtimin e çështjes në fakt.

Gjithashtu Gjykata vendimin e saj e ka bazuar vetëm mbi analizën e provave që ka administruar gjykata e faktit, edhe pse haptazi duket se dispozitivi i vendimit të kësaj të fundit s'ka asnjë kontradiktë me pjesën arsyetuese. Për më tepër që si gjatë gjykimit e në përfundim pala e paditur ka qenë për pranimin e padisë. Duke vepruar në këtë mënyrë, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin e tij ka tejkaluar tagrin që i ka dhënë neni 7 i Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 "Për Organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese", atë të shqyrtimit "vetëm të bazës ligjore të vendimeve gjyqësore...".

Në këto kushte vendimi nr.186, datë 13.2.1996 i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit është antikushtetues sepse është shkelur neni 38 i Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 për "Të Drejtat

dhe Liritë Themelore të Njeriut", konkretisht e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kërkuesi ka pretenduar edhe se Gjykata e Kasacionit e ka shqyrtuar çështjen pa e shpallur ditën e gjykimit. Meqënëse në këtë drejtim nuk ka prova, Gjykata Kushtetuese nuk e merr për bazë një pretendim të tillë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri,

V E N D O S I:

Të shfuqizojë si antikushtetues vendimin nr.186, datë 13.2.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
Tiranë, më datë 21.11.1997